

LIGJ
Nr.8416, datë 12.10.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7866, DATË 6.10.1994 "PËR REFERENDUMET"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7864, datë 6.10.1994 "Për referendumet" neni 16 ndryshohet si vijon:

"Për organizimin dhe zhvillimin e referendumit zbatohen të gjitha dispozitat e parashikuara në kreun e dytë të ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal", me ndryshimet përkatëse, me përjashtim të neneve 24, 25, 26, 27, 30.

Komisionet e qendrave të votimit, si dhe komisionet e komunave dhe të bashkive përbëhen nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari, si dhe nga katër anëtarë; dy janë përfaqësues të pozitës dhe dy të tjerë janë përfaqësues të opozitës qeveritare, që caktohen nga subjektet (subjekti) me nivel më të lartë përfaqësimi në këshillat e komunave dhe bashkive.

Komisionet e rretheve përbëhen nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe një përfaqësues i çdo subjekti ose grupimi elektorale, që përfaqësohet në këshillin e rrethit dhe nga një anëtar pa parti kur numri del çift.

Komisioni i rrethit miratohet dhe shpallet nga Komisioni Qendror i Votimeve. Komisioni i bashkisë dhe i komunës miratohet dhe shpallet nga kryesia e komisionit të rrethit përkatës. Komisioni i qendrës së votimit miratohet dhe shpallet nga kryesia e komisionit të bashkisë dhe komunës përkatëse.

Në të gjitha nivelet, kryetari është përfaqësues i Qeverisë, zëvendëskryetari nga partia ose subjekti elektorale që nuk merr pjesë në koalicionin qeveritar dhe ka përfaqësim më të lartë në këshillin përkatës, ndërsa sekretari dhe personi pa parti propozohen nga prefekti. Zëvendëskryetari gëzon pozitë juridike të barabartë me kryetarin.

Propozimet për përbërjen e komisionit të rrethit bëhen në Komisionin Qendror të Votimeve jo më vonë se 25 ditë dhe miratimi dhe shpallja prej tij jo më vonë se 23 ditë para ditës së votimit. Propozimet për përbërjen e komisionit të komunës dhe bashkisë bëhen në komisionin e rrethit jo më vonë se 20 ditë dhe miratimi dhe shpallja prej kryesisë së tij bëhet jo më vonë se 18 ditë para ditës së votimit. Propozimet për përbërjen e komisionit të qendrës së votimit bëhen në komisionin e bashkisë e komunës jo më vonë se 15 ditë dhe miratimi dhe shpallja prej kryesisë së tij jo më vonë se 10 ditë para ditës së votimit."

Neni 2

Neni 26 ndryshohet si vijon:

"Votimi për referendumet bëhet ditën e caktuar, nga ora 700 deri në orën 1800."

Neni 3

Neni 27 ndryshohet si vijon:

"Fleta e votimit ka të shkruar në krye të saj në formë pyetje objektet e referendumit. Në të majtë të fletës janë të shkruara dy mundësitë "PO" dhe "JO"; në të djathtë, në linjë korresponduese dy kuadrate ku do të vihet shenja nga votuesi. Votuesi vë shenjën "+" në kuadratin pranë alternativës në favor të së cilës ai është."

Neni 4

Në neni 30, pika c ndryshohet si vijon:

"c. Nuk është shënuar në asnjë nga kuadratet e fletës së votimit ose është shënuar në të dyja."

Neni 5

Pas nenit 30 shtohet neni 30/1 si vijon:

"Neni 30/1

Fleta e votimit është e vlefshme edhe kur nuk është respektuar me përpikëri shenja apo pozicioni i vendosjes së saj, të përcaktuara në nenin 27, por është shprehur qartë vullneti i votuesit."

Neni 6

Në neni 31, paragrafi i fundit ndryshohet si vijon:

"Për hartimin e procesverbaleve të komisioneve të qendrave të votimit, të komisioneve të bashkive, komunave e rretheve ndiqen procedurat e përcaktuara në nenin 76 të ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal", me ndryshimet përkatëse, paragrafi i katërt, i pestë, i gjashtë dhe i shtatë (i fundit)."

Neni 7

Në nenin 32, pas fjalës "... kryetari ...", shtohet fjala "... zëvendëskryetari...".

Neni 8

Në nenin 33, pas fjalëve "... së bashku me.." shtohen fjalët "... dy kopjet e procesverbaleve të qendrave të votimit..."

Neni 9

Në nenin 34 paragrafi i fundit ndryshohet si vijon:

"Një kopje e procesverbalit, së bashku me një kopje të procesverbaleve të komisioneve të bashkive, komunave e qendrave të votimit, i dërgohet Komisionit Qendror të Votimeve brenda 2 ditëve nga përfundimi i referendumit, ndërsa një kopje tjetër, së bashku me procesverbalet e komisioneve të bashkive, komunave e qendrave të votimit, listat e zgjedhësve, fletët e votimit dhe vulat, dërgohen në prefekturë për ruajtje."

Neni 10

Në nenin 35, pas fjalëve "... nga komisionet e rretheve..." shtohen fjalët "... brenda 4 ditëve nga përfundimi i referendumit..."

Neni 11

Neni 36, ndryshohet si vijon:

"Kushtetuta, amendamenti apo çdo çështje tjetër për të cilën është zhvilluar referendumi quhet e pranuar kur kjo alternativë ka fituar mbi 50 për qind të votave të vlefshme."

Neni 12

Në kreun V "Dispozita të fundit", pas nenit 41 shtohet neni 41/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 41/1

Komisioni Qendror i Votimeve të Referendumit për Kushtetutën është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të pjesshme lokale të datës 21.6.1998."

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi me dekretimin nga Presidenti i Republikës.

**Shpallur me dekretin nr.2231, datë 14.10.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**